



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 28

Prishtinë, më 22 mars 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

P r o c e s v e r b a l

Nga takimi i Komisionit për Punë të Jashtme me delegacionin e parlamentarëve italianë pranë OSBE-së

Delegacioni i parlamentarëve italianë pranë OSBE- së, ishte në përbërje të deputetëve:

Riccardo Migliori, zv. president i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, z. Matteo Mecacci, president i komisionit të tretë (Komisioni për të Drejtat e Njeriut) i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së; z. Mauro Del Vecchio (PD); z. Giuseppe Caforio (IdV); z. Giuseppe Maggio, këshilltar parlamentar, sekretar i delegacionit italian i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së; z. Michael Louis Giffoni, ambasador dhe znj. Valeria Baistrocchi, këshilltare - zv.shefe e misionit.

Në takim morën pjesë: z. Albin Kurti, z. Hydajet Hyseni, z. Enis Kervan, z. Shaip Muja, z. Sabri Hamiti, z. Skender Hyseni, znj. Donika Kadaj- Bujupi, z. Amir Ahmeti dhe z. Petar Miletic.

Nga zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Takimin e kryesoi: Albin Kurti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e:

1. Takim me delegacionin e parlamentarëve italianë pranë OSBE-së,

Albin Kurti shprehu kënaqësinë për këtë takim të përbashkët të delegacionit me Komisionin, po ashtu falënderoi Italinë si një ndër shtetet e para që njohu pavarësinë e Kosovës dhe për ndihmën e vazhdueshme që i ka dhënë përmes zyrtarëve të saj në misionet e ndryshme ndërkombëtare. Ndër sfidat, ceku njohjen e mëtutjeshme të Kosovës,

pjesëmarrjen në organizata ndërkombëtare, zhvillimin ekonomik, integritetin territorial e të kufijve dhe zhvillimin demokratik drejt integritimeve evropiane, që është synim i të gjitha subjekteve politike. Gjithashtu në emër të Komisionit falënderoi OSBE-në për rolin e saj të demokratizimit në vitet e pas luftës, duke cekur pengesat dhe mangësitë që kishte gjatë veprimit në kuadër të shtyllës III të UNMIK-ut.

Michael Louis Giffoni, ambasadori i Italisë në Republikën e Kosovës, e falënderoi Komisionin për takimin dhe fillimisht prezantoi delegacionin që përbëhej nga anëtarë të Parlamentit italian, të cilët njëkohësisht, janë edhe anëtarë të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së. Ai tha se Parlamenti italian gjithmonë ka qenë si pikë referuese për një shoqëri demokratike, bashkëpunim ndërparlamentar ndërmjet vendeve mike, si dhe për perspektivën e përbashkët evropiane. Arsyeja e mbajtjes së këtij takimi tha se është për të dëgjuar mendimet mbi situatën komplekse dhe mbi sfidat që e presin këtë vend, këtë rajon në përgjithësi dhe për gjetjen e mundësive për intensifikimin e marrëdhënieve bashkëpunuese në nivel parlamentar.

Riccardo Migliori, zv. president i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së ndihet i kënaqur që gjendet në Prishtinë dhe që e ka mundësinë të bisedojë me protagonistët më të mëdhenj të politikës kosovare. Parlamenti italian është mik konstruktiv i Parlamentit të Kosovës dhe vend i cili ka arritur që politikën e jashtme ta ketë shumë të unifikuar. Qëllimi i kësaj vizite është përforcimi i marrëdhënieve ndërparlamentare, me ç'rast e ftoi një delegacion të Komisionit që ta vizitojnë Italinë. Të ardhmen e Kuvendit të Kosovës e dëshiron të integruar në asamblетë e mëdha ndërparlamentare dhe ndërkombëtare, si dhe në Asamblenë Parlamentare të OSBE-së, zëvendës-president i së cilës është. Propozoi formimin e një komisioni ad hoc, të ndryshëm nga Komisioni për Punë të Jashtme që të dialogojë me Asamblenë Parlamentare të OSBE-së, në pritje që të jetë anëtar efektiv i OSBE-së dhe mundësisë që të krijohen kontakte me delegacionet e ndryshme.

Matteo Mecacci, president i Komisionit për të Drejtat e Njeriut të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, duke cekur thënien e kryetarit Kurti se të gjitha partitë politike të Kosovës kanë synim integrimet evropiane tha se, BE-ja nuk është duke kaluar periudhat më të mira të saja si në aspektin politik, ashtu edhe në atë ekonomik. Megjithatë mosgatishmëria e BE-së, që në të ardhmen ta integrojë Ballkanin në Bashkimin Evropian, do të ishte dështim. Me rastin e mbajtjes së konferencës së Asamblesë së OSBE-së, në vjeshtë të këtij viti, në Shqipëri, propozoi që edhe delegacionit parlamentar të Kosovës t'i bëhet një ftesë nga kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, që në cilësi të vëzhguesit të marrë pjesë në zhvillimet e kësaj konference. Diskutoi edhe lidhur me zgjedhjet e Serbisë.

Albin Kurti përkrahë bashkëpunimin në mes të parlamenteve, si në aspektin multilateral, e po ashtu edhe në atë bilateral. Lidhur me dialogun me Serbinë tha se ai ka qenë pa kushte për Serbinë dhe për çështje të brendshme të Kosovës. Për të gjitha koncesionet që i ka bërë pala kosovare, Serbia nuk është mirënjohëse, as falënderuese. Serbia duhet të transformohet e jo Kosova, Kosovës nuk duhet t'i vihet fusnota, por Serbisë duhet t'i vihet fusnota. Kërkoj

ndihmën e Italisë në përputhje me njohjen e saj, në zmbropsjen e Serbisë nga aspiratat e saj hegjemoniste.

Hydajet Hyseni falënderoi delegacionin për ndihmën e shtetit italian që i ka dhënë Kosovës duke cekur se Prishtina do ta justifikoj këtë ndihmë me krijimin e një shoqërie demokratike e evropiane. Në rrugëtimin drejt integritimeve evropiane tha se Kosova ka konsensus të plotë, por përmendi edhe vështirësitë e saj të cilat ndikojnë në normalizimin e gjendjes në Kosovë. Pa normalizim të gjendjes në Kosovë tha se nuk mund të ketë as normalizim të gjendjes në Ballkan. Theksoi mungesën e kushteve të njëjta për trajtimin e problemeve që janë ekuivalente, të cilat do të ishte mirë të trajtohen me standarde evropiane, të standardizuara dhe të aplikueshme njëjtë, në të gjitha vendet. Kosovës i nevojitet ndihma e Italisë, zhvillimi i diplomacisë parlamentare, përfshirja adekuate dhe progresive në bashkëpunimin rajonal dhe në aktivitetet e OSBE-së.

Sabri Hamiti tha se në mes të dy vendeve, na nevojitet këmbimi i kontakteve, si në aspektin politik, ashtu edhe në atë kulturor. Përkrahë diskutimet paraprake që vendi ynë të gjejë mënyrën e përfaqësimit në organizatat parlamentare evropiane dhe që parlamentit tonë t'i jepet mundësia që të jetë prezent në konferencën e cila do të mbahet në Shqipëri. Duke u ndërlidhur me diskutimin e z. Mecacci, lidhur me zgjedhjet serbe, tha se Kuvendi i Kosovës ka nxjerrë një Rezolutë me vota unanime, sipas së cilës nuk lejohet mbajtja e zgjedhjeve serbe në Kosovë. Sa i përket monitorimit, tha se mirëpresim monitorimin e çfarëdo zgjedhjeve që mbahen në Kosovë dhe për Kosovën. Lidhur me mekanizmat ndërkombëtarë KFOR-in dhe EULEX-in, ka vërejtje në punën e tyre ngase KFOR-i nuk e ka shtrirë pushtetin e tij për lëvizje të lirë në veri të vendit, e po ashtu edhe EULEX-i nuk ka krijuar instrumente për sundimin e ligjit atje.

Michael Louis Giffoni, lidhur me organizimin e zgjedhjeve serbe sqaroi se z. Mecacci në diskutimin e tij, i është referuar pikës 4 të Rezolutës së miratuar në Kuvendin e Kosovës.

Donika Kadaj - Bujupi shtroi aspektin e kontributit të KFOR-it italian, në përmirësimin e jetës së qytetarëve të rajonit të Pejës si dhe pragmatizmin e këtij delegacioni për thellimin e bashkëpunimit në mes të dy vendeve, për dallim nga shumë delegacione të cilat pas largimit të tyre mungon vazhdimësia e thellimit të bashkëpunimit. Mungesa e bashkëpunimit ka për pasoj krijimin e paragjykimeve për vendin dhe popullin tonë, të cilat paragjykime më së miri do të mund të evitoheshin nëse na jepet mundësia të jemi prezent në të gjitha organizatat ndërkombëtare dhe të argumentojmë të kundërtën nga ato se çfarë shkruhet në raporte të ndryshme, të cilat jo gjithherë janë të sakta. Zgjedhjet e Serbisë nuk mund të jenë në rend dite për Kosovën, ngase Kosova është shtet i pavarur dhe sovran. Deklaratat e pushtetarëve serbë, edhe pas koncesioneve të cilat i ka bërë Kosova me qëllim të thellimit të bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes në nisma rajonale e evropiane duke e pranuar edhe një fusnotë, kanë nxitur reagimet tona për shkak të tendencave të reja të shtetit serb për të bërë një agresion të ri në territorin e Republikës së Kosovës me theks të veçantë në veri, në kohën kur Evropa ja ka hapur dyert me dhënien e statusit të shtetit kandidat. Ne nuk e kuptojmë pse bashkësia ndërkombëtare e drejton Kosovën drejt

rrezikut në të cilën sot gjendet Bosnja. Mbajtja e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë, tendencat e reja që Kosova të lëshoj pe, do ta defunksionalizojnë Kosovën, zhvillimin e mëtutjeshëm dhe do të rrezikojë stabilitetin në Ballkan.

Shaip Muja tha se me angazhimet e bëra në Kosovë, të UÇK-së, BE-së e NATO-s, është arritur që të dëbohet regjimi i fundit komunist në Ballkan. Tani aspiratat shoviniste të shtetit serb janë duke u rritur për të krijuar kriza jashtëzakonisht të mëdha në Ballkan. Prodhues i krizës në ish-Jugosllavi, ka qenë Serbia dhe është duke e bartur çmimin e saj. Në Kosovë në mënyrë sistematike janë duke u shkelur të drejtat e komunitetit serb nga vetë Serbia, duke u thirrur në emër të nacionalizmit. Intencat e Serbisë përmes strukturave të saj në veri të Kosovës, tentojnë të bëjnë jofunksional jo vetëm Republikën e Kosovës, por janë duke paraqitur sprovë edhe për UNMIK-un e KFOR-in. Falënderoi delegacionin italian për ofrimin e mundësisë për zhvillimin e diplomacisë parlamentare.

Albin Kurti duke u ndërlidhur me zgjedhjet e Serbisë tha se ne do të dëshironim që Serbia ta ketë ambasadën e saj në Prishtinë, ta ketë ndryshuar Kushtetutën e saj ku do ta pranonte Kushtetutën e Kosovës dhe atëherë qytetarët të cilët do ta kishin dyshtetësinë, do të mund të votonin në ambasadën e tyre në kuadër të zgjedhjeve të Serbisë.

Mauro Del Vecchio duke cekur rolin e dyfishtë të cilin e ka delegacioni tha se si parlamentarë dëshirojnë që raportet e mira të cilat ekzistojnë në me të dy parlamenteve të intensifikon, ndërsa si anëtarë të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, dëshirojnë të dëgjojnë edhe zërin e Kosovës. Vërejtjet e parashtruara nga anëtarët e Komisionit tha se do t'i kenë parasysh dhe kërkojnë që t'ju ndihmojmë në zhvillimet e mëtutjeshme. Për koncesionet e shumta të bëra për të ardhmen tha se është i sigurt se përmes tyre do të jetë më e lehtë arritja e qëllimit që aspirohet.

Giuseppe Caforio tha se përfaqëson një pjesë të opozitës parlamentare italiane, dhe zona nga ai vjen ka një miqësi shumë të madhe për Kosovën. Forca politike të cilën e përfaqëson mbështetë stabilizimin e rajonit dhe zhvillimin e marrëdhënieve dypalëshe me Italinë, e me vendet e tjera.

Enis Kervan tha se përfaqëson komunitetin turk, boshnjak e rom të cilët kanë të drejta të mëdha të cilat mund të jenë një model i shkëlqyeshëm në rajon. Për çështjet që diskutohen lidhur me shtetin e Kosovës, tha se kemi qenë dhe jemi edhe më tutje pro institucioneve të Kosovës. Lidhur me zgjedhjet e Serbisë në veri, tha se ne e përkrahim fuqishëm Rezolutën e Kuvendit të Kosovës.

Riccardo Migliori falënderoi Komisionin për këtë takim duke shtuar dëshirën për intensifikimin e marrëdhënieve ndërparlamentare dhe realizimin e një vizite të Komisionit për Punë të Jashtme në Itali.

Albin Kurti falënderoi delegacionin për këtë takim të përzemërt dhe të dobishëm.

Takimi përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti